REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/ K 10-10 Prot. **Tiranë, 06/03/2023**
Nr. Dok. 202201256/10

Lënda: *Rekomandim për hartimin dhe zbatimin e një plani për formimin e vazhdueshëm profesional të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Kukës*

BASHKISË KUKËS

Të nderuar!

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi K. P. , banues në Fshatin B., Njësia Administrative A., Bashkia Kukës. Objekti i kësaj ankese lidhet me ndërprerjen e ndihmës ekonomike për familjen e ankuesit.

Institucioni i Avokatit të Popullit në vazhdim të hetimit administrativ për zgjidhjen e problematikës së ngritur nga qytetari, në përgjigje të shkresave të tij për shpjegime drejtuar Bashkisë Kukës, ka konstatuar se në të dy përgjigjet lidhur me rastin e trajtuar që Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, Bashkia Kukës i drejton institucionit të Avokatit të Popullit, ka mungesë të theksuar të njohurive të legjislacionit të përditësuar për Shërbimin Social.

Konkretisht:

Në shkresën Tuaj nr. 6389/1 Prot, datë 15.11.2022 "Kthim Përgjigje" (tonës), shkruhet se *familja e z. K. P. është penalizuar në përfitimin e ndihmës ekonomike në bazë të Vendimit nr. 598/1 Prot, datë 29.06.2022 të Shërbimit Social.* ***Vendimi është bazuar në ligjin nr. 9355, "Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore" si dhe VKM nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentcionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike. Kreu II, Pika 11/ç,*** *e cila thotë se; Përjashtohen nga përfitimi i Ndihmës Ekonomike, për një periudhë 6 mujore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm qe plotëson kushtet e mëposhtme*
ç) fshehin informacion apo kryen deklarim të rremë.

Gjithashtu, në shkresën Tuaj nr. 6389/1 Prot, datë 25.11.2022 "Kthim Përgjigje" (tonës) shkruhet se *familja e z. K. P. është penalizuar në përfitimin e ndihmës ekonomike në bazë të Vendimit nr. 598/1 Prot, datë 29.06.2022 të Shërbimit Social.* ***Vendimi është bazuar në ligjin nr. 9355, "Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore" si dhe VKM nr.***

955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentcionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike. Kreu II, Pika 11/a, *e cila thotë se;*
Përjashtohen nga përfitimi i Ndihmës Ekonomike, për një periudhë 6 mujore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm qe plotëson kushtet e mëposhtme
a) Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes që jetojnë në të njëjtën strehë.

Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, ndryshuar me Ligjin nr. 9602, datë 28.07.2006; Ligjin 10252, datë 11.03.2010; Ligjin nr. 25/2013; Ligjin nr. 44/2016 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" është shfuqizuar me miratimin e Ligjit 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë". Me shfuqizimin e këtij ligji janë shfuqizuar dhe aktet nënligjore, konkretisht VKM nr. 955, datë 07.12.2016 është shfuqizuar me miratimin e VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike."

Për rastin konkret, mosnjohja e legjislacionit dhe referimi i gabuar i tij nuk ka sjellë pasoja për ankuesin, pasi Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Kukës e ka trajtuar rastin bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, sa vërtetohet nga shkresat përgjigje tonës nga ky institucion. Megjithatë, shqetësues për Avokatin e Popullit mbetet fakti se referimi në bazë ligjore të shfuqizuar mund të sjellë si pasojë trajtimin dhe orientimin e gabuar të çështjeve që paraqiten nga aplikuesit për mbështetje sociale.

Njohja e legjislacionit bazë që rregullon fushën specifike për një procedurë të caktuar administrative është element thelbësor jo vetëm për imazhin e administratës publike, e cila duhet të përfaqësojnë një trupë të specializuar nëpunësish që shërbejnë në funksion të interesit më të lartë publik, por edhe për vlefshmërinë e procedurës administrative e të aktit administrativ. Zbatimi i ligjit të gabuar përbën shkak për paligjshmërinë e aktit administrativ, duke sjellë si pasojë dhe pavlefshmërinë e tij në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, e duke shkaktuar kështu rrjedhimisht edhe zvarritje të panevojshme, herë administrative e herë gjyqësore.

Legjislacioni i shërbimit civil ka rregulluar me një kuadër të posacëm cështjen e formimit të vazhdueshëm të nëpunësve civilë, duke krijuar një institucion të dedikuar për trajnimin e nëpunësve civilë, që është Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Nga ana tjetër, theksi tek nevoja për përditësimin e vazhdueshëm të njohurive të nëpunësve civilë është vendosur edhe nga Vendimi nr. 1037, datë 16/12/2015 i Këshillit të Ministrave, "*Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë*", i cili parashikon procedura të hollësishme sa i takon përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë me synim aftësimin e nëpunësve civilë dhe pajisjen e tyre me njohuritë shtesë të nevojshme, sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të punës në institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil.

Parë në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme marrja e masave për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në njesitë organizative të shërbimit social të Bashkisë Kukës mbi njohjen e legjislacionit që rregullon fushën e shërbimeve sociale, duke qëndruar në koherencë me dinamikën e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive";

R E K O M A N D O N:

Marrjen e masave për hartimin dhe zbatimin e një plani për formimin e vazhdueshëm profesional të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Kukës me fokus njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor të Mbrojtjes Sociale në Republikën e Shqipërisë.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

VILMA SHURDHA

DV